

2200

7/5/23, 3:13 PM

Gmail - Re: Kerkese per informacion

Re: Kerkese per informacion

Koordinatori <koordinatori@ere.gov.al>
To: Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>
Cc: Enti Rregullator i Energjise <erealb@ere.gov.al>

Mon, May 29, 2023 at 5:18 PM

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës Suaj, të protokolluar në Entin Rregullator të Energjisë, me nr. 1442 prot., datë 22.05.2023, ju informojmë si vijon:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 41, datë 10.03.2022, i ndryshuar, ka licencuar shoqërinë "AGE KUÇ" shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Sa i përket lejes së shfrytëzimit të burimit ujqor, në përgjigje të kërkesës së ERE-s për informacion, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore, e cila është dhe organi përgjegjës për menaxhimin e burimeve ujqore, me shkresën nr. 125/3 prot., datë 16.05.2023, ka njoftuar ERE-n se aplikimi për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor për HEC Kuç nga subjekti "AGE KUÇ" është regjistruar në sistem në datën 18.1.2023 dhe aplikimi është në proces trajtimi nga organet e menaxhimit të burimeve ujqore.

Sa i përket VNM paraprake, ju njoftojmë se subjekti ka depozituar në ERE këtë dokument, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, siç reflektuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 299, Datë 18.11.2022.

Gjithashtu, ju informojmë se shoqëria "AGE KUÇ" shpk nuk ka filluar ende ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

Me respekt,
Erato Sinani